

Bismilahirrahmanirrahim

Progresi i Ahmediatit

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا.

"Idhaa xhaa anasrullahi wal fat'h. Va raajta naasa jadhkhaluna fii diini laahi afwaxha. Fasabih bihamdih rabbika va staghfir. Inna huu kaana tavvaaba".

Përkthimi :

"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe fitorja; dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe. Lartësoje Zotin tënd me lavdërime dhe kërko falje nga Ai. Me të vërtetë Ai është pranues i pendimeve". (Sureja An-Nasr).

Në skriptet e të gjitha religjioneve të mëdha të botës gjejmë profeci të shumta për ardhjen e një reformatori të madh Hyjnor në kohët e vona. Më të shumta, këto profeci i gjemë në librat e haditheve të Profetit të shenjtë të Islamit, Hazret Muhamedit^{sas}. Në to edhe koha e ardhjes së tij është caktuar dhe shumica e dijetarëve myslimanë ishin dakord se fundi i shekullit të 13 dhe fillimi i shekullit të 14 të hixhrit - që korrespondon me dekadën e fundit të shekullit të 19 - ishte koha kur ky Imam Hyjnor do të paraqitej. Qëllimi i ardhjes së tij do të ishte fshirja e pluhurit shekullor nga fytyra e Islamit, që bota edhe një herë të mund ta shihte bukurinë e vërtetë të religjionit të përkryer. Ai do të vinte edhe për t'i dhënë Islamit triumfin përfundimtar mbi të gjitha fetë e tjera të botës.

Edhe shumë sekte krishtere, të bazuara në profecitë e shumta në skriptet e tyre, e kishin caktuar fundin e shekullit të 19 dhe fillimin e shekullit të 20 për ardhjen e dytë të Mesihut të tyre.

Sipas profecive që gjenden në Ingjil shenjat e paraqitjes së dytë të Mesihut do të jenë tërmetet, mortajat, epidemitë, luftërat dhe çrregullimet e tjera të shumta që do të mbretëronin në tokë. Ndërsa në hadithet e Profetit të Shenjtë^{sas}, nga lista e gjatë e shenjave që do ta paralajmëronin ardhjen e tij, do të veçojmë shenjën e eklipsit të hënës dhe të diellit që do të ndodhnin në ditët e caktuara, në të njëjtin muaj të Ramazanit. Kjo do të ishte shenja e ardhjes së Imam Mehdiut, shenjë kjo, që sipas Profetit të Shenjtë^{sas} nuk ishte paraqitur në favor të askujt që prej krijimit të tokës dhe qiejve.

Aty nga gjysma e dytë e shekullit të 19, në një qytezë të vogël të Indisë, në Kadijan, jetonte një njeri i devotshëm i cili ia kishte dedikuar jetën e tij adhurimit të Allahut. Ai nuk ishte i interesuar në asgjë tjetër që e rrethonte. Rridhte nga një familje relativisht e pasur, por në vend që të shoqërohej me njerëz të klasës së pasur, atë e gjeje gjithmonë duke u interesuar për hallet e të varfërve dhe nuk turpërohej të shoqërohej me ta. Njihej për ndershmërinë e tij absolute, për dashurinë e madhe ndaj Allahut, ndaj të Dërguarit të Tij dhe ndaj librit të Tij - Kuranit.

Rreth moshës 40 vjeçare, ai filloi të pranonte revelatat e para nga Allahu i Madhërishtëm, të cilat sa vinin e shtoheshin me kalimin e kohës. Emri i tij ishte Ghulam Ahmed që do të thotë shërbëtor i Muhamedit. Më 1889 ai pohoi se Allahu e kishte informuar se ai ishte Imam Mehdiu. Më vonë ai pohoi se ishte edhe Mesihu i Premtuar. Në fakt ai ishte ai profet që ishte premtuar nga të gjitha fetë kryesore të botës i cili do të vinte për ta reformuar botën në ditët e vona. Ai, më 1889, nën komandën Hyjnore, e themeloi një komunitet besimtarësh të zgjedhur, i cili më vonë u njoh me emrin **Xhemati Mysliman Ahmedia**.

Disa ditë para themelimit të Xhematit, ai në një shpallje shkroi: **"Allahu dëshiron ta themeloj një komunitet të besimtarëve për ta manifestuar Madhësitinë dhe Fuqinë e Tij. Ai do ta bëjë këtë komunitet të rritet dhe të përparoj, për ta vendosur dashurinë e Allahut, devotshmërinë, dëlirësinë, sinqeritetin, paqen dhe vullnetin e mirë ndër njerëz. Ky do të jetë një grup besimtarësh të dedikuar Allahut. Ai do t'i forcojë ata me Shpirtin e Tij dhe do t'i bekojë e pastrojë ata. Ai, sipas premtimit të Tij, do t'i shumëfishoj ata jashtëzakonisht. Mijëra njerëzish të çiltër do t'i bashkëngjiten radhëve të Tij. Ai Vetë do të kujdeset për ta dhe do ta bëjë këtë komunitet të rritet aq shumë sa që numri dhe progresi i tij do ta habisë botën. Ky Xhemat do të jetë një fanar aq i lartë sa të mund t'i ndriçoj të katër anët e botës. Anëtarët e tij do të shërbejnë si shembuj të bekimeve Islame. Pasuesit e mi të vërtetë do t'ia kalojnë çdo popull tjetër. Gjithmonë, deri në ditën e Gjykimit do të ngritën personalitete që do të jenë të zgjedhurit e Allahut në çdo respekt. Kështu ka vendosur Allahu që të bëhet dhe Ai bën ç'të dëshirojë"**.

Profecitë e shumta që priteshin të plotësoheshin në kohën e tij, u plotësuan dhe katër vjet pas themelimit të Xhematit ndodhën edhe eklipset e shumëpritura të hënës dhe të diellit. Ai kishte ardhur për ata që kishin sy e mendje të shëndoshë, dhe ata e pranuan duke parë me sytë e tyre përmbushjen e qindra mijëra shenjave të pamohueshme. Në fakt e gjithë jeta e tij dhe vetë personi i tij ishin

një argument i pamohueshëm. Por, mohues të profetëve ka pasur gjithmonë në të kaluarën dhe do të kishte edhe kësaj here.

Ai gjatë jetës së tij shkroi mbi 80 libra dhe mbajti shumë fjalime në të cilat ia sqaroi botës pozitën e tij dhe qëllimin e ardhjes së tij. Por askush nuk do të jetonte përgjithmonë dhe edhe jetës së tij do t'i vinte fundi. Ai në një vend shkruan: **"Unë kam ardhur ta mbjellë vetëm farën dhe kjo farë është mbjellë nga dora ime. Tani kjo farë do të rritet e do të lulëzohet. Ajo do të japë fryte dhe nuk ka fuqi në tokë që mund ta dëmtojë e ta çrrënjosë këtë farë"**. (Tazkiratush-Shahadeten, faqe 64-65).

Pra, Allahu e kishte dërguar atë vetëm për ta mbjellë farën, e cila do të rritej e do të jepte fryte pas vdekjes së tij. Ai thoshte se Zoti e kishte lajmëruar se pas tij do të themelohej sistemi i Kalifatit i cili do të vazhdonte pakëputshëm deri në ditën e fundit të botës.

Më 1908, themeluesi i Xhematit Ahemdia, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi - Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu ndërroi jetë. Hazret Maulana Hakim Nurudini^{ra}, unanimitisht u zgjodh zëvendës i tij. Ai duke ecur besnikërisht gjurmëve të mësuesit të tij, e udhëhoqi Xhematin deri në vdekje më 13 mars 1914, ditë e premte.

Hazret Maulana Hakim Nuruddin Sahib^{ra} (Kalifi i parë i Mesihut të Premtuar^{sas}) ishte një personalitet kolosal, autor i talentuar, dijetar i shquar, njeri jashtëzakonisht i devotshëm dhe teolog shumë i madh. Falë njohurive të tija në fushën e mjekësisë, ai shërbeu për shumë vite si mjek në oborrin mbretëror të Maharaxhës së Xhamusë dhe Kashmirit.

Në kërkim të diturisë, ai udhëtoi në të katër anët dhe qe i privilegjuar të kalonte katër vjet në qytetet e shenjta të Mekës dhe Medinës. Kontributi i tij në shërbim të Islamit është i paprecedan në analet e Ahmediatit. Mesihu i Premtuar^{ass} e ka lavdëruar atë në një poemë të tijën në persisht, e cila është një dëshmi e bukur e statusit të tij të veçantë: **"Sa mirë do të ishte, sikur secili prej pasuesve të mi do të ishte Nurudin. Kjo është e mundur vetëm kur zemra e njeriut të ndriçohet nga drita e vërtetësisë dhe besimi i palëkundshëm"**.

Disa prej arritjeve të tija të veçanta janë: vënia e themeleve të institucionit të Kalifatit, puna në përkthimin e Kuranit të shenjtë në gjuhën angleze, themelimi i misionit të parë të jashtëm në Londër, zgjerimi i Mesxhidul Aksasë dhe i shkollës Talimul Islam High School, inaugurimi i spitalit Nur dhe i xhamisë Nur, fillimi i një numri revistash dhe publikimesh si: 'Al Fazel' dhe 'Nur' nga Kadijani, 'Al Hak' nga Delhi dhe 'Peghami Sulha' nga Lahori.

Pas vdekjes së Kalifit të Parë, Kalif i dytë u zgjodh Mirza Bashirudin Mahmud Ahmedi. Ai në atë kohë ishte vetëm 25 vjeç dhe qëndroi në krye të Xhematit për

52 vitet e ardhshme duke e udhëhequr Xhematin në mënyrë shembullore. Njëra prej arritjeve të tija më të mëdha ishte themelimi i një sistemi të fortë të predikimit të mesazhit të Islamit brenda dhe jashtë vendit. Fill pas zgjedhjes së tij në krye të Xhematit ai deklaroi se detyra kryesore dhe misioni i tij ishte përhapja dhe predikimi i Islamit brenda dhe jashtë vendit. Para se të ndahej nga kjo jetë, ai kishte arritur që t'i themelonte misionet e Xhematit në 46 vende të ndryshme të botës.

Kalifi i dytë ishte njëherit edhe djali i Mesihut të Premtuar, për lindjen e të cilit Allahu e kishte lajmëruar atë në një revelatë. Në atë revelatë ai është quajtur "Reformatori i Premtuar". Revelata ishte shumë e përpiktë duke e caktuar afatin e lindjes së tij dhe kualitet e shumta që do t'i posedonte ai. Të gjitha ato profeci u plotësuan gjatë jetës së tij dhe ky përbën njërin prej argumenteve më të forta të Mesihut të premtuar dhe të Xhematit të tij.

Allahu e kishte bekuar atë me dituri të thella të Kuranit të Shenjtë. Më vonë ai i botoi komentimet e tij në një përmbledhje 10 vëllimesh e njohur si 'Tafsire Kabir'. Sukseset e tija ishin të shumta edhe në përkthimin e Kuranit në gjuhë të ndryshme të botës, punë kjo që vazhdoi me intensitet të shtuar edhe gjatë Kalifëve që e pasuan deri më sot. Kontributi i tij në forcimin e themeleve të Kalifatit Ahmedia është shumë i madh, sepse e dinte se Kalifati ishte vetë jeta e Xhematit.

Ai thoshte: "Vëllezër, këshilla ime e fundit është, se të gjitha bekimet gjenden në Kalifat. Profetizmi është një farë e hedhur pas së cilës Kalifati e shpërndanë mirësinë në botë. Mbahuni fort për Kalifatin e vërtetë dhe shpërndani bekimet e tij në botë. Allahu do të jetë i mëshirshëm ndaj jush dhe do t'u bekoj juve në këtë dhe në botën tjetër".

Pas ndarjes së Indisë dhe themelimit të Pakistanit, qendra e Xhematit u zhvendos nga Kadijani i Indisë, në Pakistan ku në mes të shkretëtirës iu vunë themelet qytetit të Rabvahit. Tani Rabvahi është një qytet i mirëfilltë.

Më 1965, pas vdekjes së Kalifit të dytë, Hazrat Mirza Nasir Ahmed u zgjodh kalif i tretë i Xhematit Ahmedia. Gjatë kalifatit të tij Xhemati Ahmedia në Pakistan zyrtarisht u deklarua si një minoritet jashtë fesë Islame.

Nën udhëheqjen e Hazret Mirza Nasir Ahmedit (Allahu pastë mëshirë ndaj tij) Xhemati Ahmedia përparoi me një shpejtësi të madhe në propagandimin e Islamit në gjithë botën, duke ndërtuar dhe udhëhequr shkolla, kolegje, spitale, qendra predikuese, xhami, duke përkthyer dhe botuar Kuranin e Shenjtë dhe literaturë tjetër fetare etj. Ai e udhëhoqi Xhematin nëpër fazat më të vështira të historisë së tij.

Më 1982, pas vdekjes së tij Hazret Mirza Tahir Ahmedi u zgjodh Kalif i Katërt. Persekutimi i ahmedianëve vazhdoi të rritej dhe armiqtë po tërboheshin duke parë suksese të reja të Xhematit Ahmedia. Tani edhe vetë kalifi i Xhematit po akuzohej për krime të pa bëra. Më 1984, kur qëndrimi në Pakistan po bëhej i pamundshëm për Kalifin, ai e lëshoi Pakistanin dhe emigroi në Angli. Shpëtimi nga kthetrat e armikut ishte një mrekulli në vete.

Dëbimin e tij nga atdheu, armiqtë mund ta quanin një sukses të madh, por, pas këtij emigrimi, për Xhematin filloi një epokë e artë e sukseseve të njëpasnjëshme. Numri i anëtarëve po rritej dhe xhimate të shumta lokale po themeloheshin në zemër të Evropës. Kalifi bëri shumë udhëtime historike nëpër vende të ndryshme të botës ku u prit në shumë raste nga kryetarë e mbretër. Predikimi i mesazhit tani po bëhej në më shumë se 150 vende të botës.

Më 1987 dy mbretër fisesh të Nigerisë u anëtarësuan në Xhematin Ahmedia duke e përmbushur kështu edhe një herë revelatën e Mesihut të Premtuar, **"Mbretërit do të kërkojnë bekime prej rrobave tuaja"**. Në Xhalsa Salanën e vitit 1987 në Londër, ku ata kishin ardhur për të marrë pjesë, Hazuri u dhuroi atyre relikte të shenjta të Mesihut të Premtuar^{ass}.

Mesihu i Premtuar^{ass} ishte dërguar nga Allahu për ripërtëritjen e Islamit dhe propagandimin e Kuranit të Shenjtë. Gjatë kohës së Kalifit të Katërt puna në përkthimet dhe botimet e Kuranit vazhdoi me një hov të shtuar. Përkthimet në më shumë se 50 gjuhë të ndryshme u përgatitën dhe u botuan.

Diktatori famëkeq i Pakistani Zia-ul Haku e ndaloi publikimin e shumë librave, revistave e gazetave të Xhematit duke u munduar ta mbyste zërin e ahmediatit. Nga ana tjetër, më 21 gusht 1992, nga Londra filluan transmetimet e para të stacionit të parë televiziv Islamik botëror - MTA-së. Në fillim emitonte vetëm për disa orë në ditë, ndërsa tani janë tri kanale që emetojnë 24 orë në ditë. Tani, me ndihmën e Allahut, zëri i Islamit të vërtetë po i arrin të katër anët e botës. Hutbet e xhumasë së Kalifit të Kohës dëgjohen live duke u përkthyer drejtpërdrejt në 8 gjuhë të botës. Nuk besoj të ketë ndonjë tjetër stacion televiziv në botë që të mbahet vetëm nga vullnetarët, siç është MTA-ja.

Pas vdekjes së Kalifit të Katërt, në prill 2003, në krye të Xhematit u zgjodh Hazret Mirza Masrur Ahmedi. Zgjedhja e tij rrodhi si ishte më së miri dhe pa asnjë incident të vetëm. Kjo ishte në fakt një tjetër mrekulli dhe argument se është vetë dora e Zotit ajo që është duke e mbështetur xhematin Ahmedia. Ai fill pas pranimit të detyrës së tij, ndërmoi një mori udhëtimesh nëpër botë që u treguan shumë të suksesshme.

Folëm për sukseset e Xhematit Ahmedia, por, në fakt sukcesi më i madh i xhematit tonë është Kalifati që është duke vazhduar për 99 vitet e fundit, dhe

për keqardhjen e kundërshtarëve tanë, nuk është duke treguar shenja dobësimi, por për kundrazi. Kalifati, pra është ajo që na dallon ne nga të gjithë të tjerët. Më thoni, a është i vogël dallimi mes një shteti me kryetar dhe një tjetri pa të? Apo të një ushtrie me gjeneral dhe një tjetre pa gjeneral? Apo në mes të një xhemati me Imam dhe një tjetri pa të?

Xhematin të cilin e themeloi Mesihu i Premtuar 118 vjet më parë, është një mishërim i mesazhit mirëdashës të Islamit - paqe, vëllazëri universale dhe nënshtrim ndaj vullnetit të Allahut. Mesazhi i tij ishte për tërë njerëzimin. Me këtë bindje, Xhemati Ahmedia, brenda pak më shumë se një shekulli i ka arritur skajet më të largëta të tokës. Kudo që themelohet ndonjë degë e re e Xhematit, anëtarët e tij përpiqen ta shpërndajnë ndikimin konstruktiv të Islamit përmes projekteve sociale, institucioneve arsimore, shërbimeve mjekësore, publikimeve Islamike dhe ndërtimit të xhamive.

Me gjithë persekutimin e hidhur në disa vende, Ahmedianët e kanë fituar epitetin e të qenurit respektues të ligjeve të vendeve ku jetojnë, këmbëngulës, bujarë dhe të dobishëm për shoqërinë. Xhemati Mysliman Ahmedia u themelua nën komandën Hyjnore me qëllim që t'i rilindë moralet e larta Islame dhe vlerat e braktisura shpirtërore. Ai inkurajon dialog ndërfaqësor dhe përpiqet ta mbrojë Islamit dhe mundohet t'i ndreq keqkuptimet rreth Islamit në Perëndim dhe më gjerë. Predikon paqe, tolerancë, dashuri dhe mirëkuptim ndër pasuesit e feve të ndryshme. Vepron sipas mësimit Kuranor "**La ikraha fii diin**" - "**Nuk ka dhunë në fe**". Fuqishëm e lufton dhunën dhe terrorizmin e çfarëdo forme dhe për çfarëdo arsye të bëhet.

Bota arriti ta njoh Xhematin Ahmedia edhe përmes disa prej anëtarëve të tij, që ishin edhe figura me renome ndërkombëtare, si i ndjeri Sër Muhamed Zafrullah Khan i cili shërbeu si Ministër i parë i jashtëm i Pakistanit, si Kryetar i Asamblesë së 17^{të} të Kombeve të Bashkuara, si Kryetar i Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës dhe Dr. Abdus Salami, Laureat i Çmimit Nobel për Fizikë në vitin 1979.

Ishte i dobët e i pafuqishëm Mesihu i Premtuar dhe kishte vetëm pak njerëz rreth vetes së tij, kur Zoti ia zbriti revelatën "**Me teri tabligh ko zamin ke kenaru tak puhnqaunga**" – "**Unë do ta qoj mesazhin tënd deri në skajet e fundit të botës**". Sot edhe ne jemi dëshmitar se mesazhi i tij ka arritur edhe një skaj tjetër të botës, vendin tonë dhe themelimi i xhematit Ahmedia në Kosovë dhe vetë xhalsa e sotme është një dëshmi për këtë. Kush tjetër mund t'i thoshte këto fjale të mëdha, pos atij që kishte dijen prej Zotit.

Sukseset që i përmendëm janë vetëm fillimi, dhe Xhemati Ahmedia sipas premtimit të Allahut do triumfojë në botë brenda tre shekujve. Unë po e

përfundoj fjalimin tim me një thënie të Mesihut të Premtuar që flet për të ardhmen e këtij Xhemati Hyjnor. "...S'do të kalojnë tre shekuj prej sodit që myslimanët dhe të krishterët do ta hedhin poshtë me hidhërim, dëshpërim e urrejtje këtë besim të rrejshëm (besimin se Isa^{as} është në qiell dhe do të zbres prej atje në kohët e vona). Atëherë në botë do të mbetet vetëm një religjion dhe vetëm një udhëheqës. Unë kam ardhur ta mbjellë vetëm farën dhe kjo farë është mbjellë nga dora ime. Tani kjo farë do të rritet e do të lulëzohet. Ajo do të japë fryte dhe nuk ka fuqi në tokë që mund ta dëmtojë e ta çrrënjosë këtë farë". (Tadhkiratush-Shahadetain, f. 64-65).

Z. Musa Rrustemi

Kryetar i Xhematit Ahmedia –Kosovë

Fjalim i mbajtur me rastin e Xhalsa Salanës, 6 maj 2007-Kosovë